



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.07.2022

MBLEDHJA Nr. 30,
Datë 07.07.2022, ora 10:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 07.07.2022, ora 10:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 30 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 28.06.2022
2. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Qershor 2022
3. Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kodit të shpërndarjes
4. Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 93, datë 28.04.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “ECO - ELB” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali i përpunimit të mbetjeve urbane, me kapacitet të instaluar 2850 kW”
5. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “M&K Energy Trading CO” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
6. Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “OST” sh.a. për miratimin e transferimit të asetëve të investimit të kryer nga zbatimi i projektit “Supply and Instalation of Transmission Meter/Data Center” nga OST sh.a. tek OSHEE Group sh.a.
7. Mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e bordit të ERE-s nr. 144, datë 06.06.2022, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 415, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Blac Energy” sh.p.k. me vendimin e bordit të ERE-s nr. 157, datë 09.07.2018”
8. Çështje të tjera

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI